



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. 12141 Prot

Shkodër, më 17.6.2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacioni “Për një ndryshim në VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për një ndryshim në VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. ____ Prot

Shkodër, më _____.____.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2025

Për një ndryshim në VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.____.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh” të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; ligjit nr. 69/2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar; VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, pika 1 germa g), sa i takon numrit total të punonjësve të Bashkisë Shkodër, sipas tabelës nr.11, pjesë përbërese e këtij vendimi.
2. Fondi i pagave për punonjësit shtesë të Bashkisë Shkodër përballohet nga fondet e trashëguara nga viti 2024 pjesë e buxhetit të bashkisë të vitit 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.


KRYETAR

Benet BECI

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al


ZV/KRYETAR

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse




Drejtoria Juridike

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve mbështetëse



Drejtoria e Administrimit të Sistemeve,
Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe
Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit




Njësia e Prokurimeve



Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit



Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar



Drejtoria e Arsimit




Drejtoria e Taksave dhe Tarifave
Vendore



Drejtoria e Përgjithshme
Mirëmbajtjes së Objekteve Publike



Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike



Ishte*

NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2025

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri punonjësve të miratuar	Numri punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	618	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	141	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	238	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	55	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		1052	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar	2141001	20	
TOTALI		1072	20

* Në numrin total janë të përfshirë shtesa prej 13 punonjësish pranë Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, institucion në varësi të Bahkisë Shkodër sipas shkresës nr.10535 prot., datë 26.05.2025 drejtuar Këshillit Bashkiak.

Bëhet

NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2025

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri punonjësve të miratuar	Numri punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	629	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	141	10
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	243	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	55	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		1068	30
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar	2141001	20	
TOTALI		1,088	30

KRYETAR
Benet BECI

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

RELACION

Për një ndryshim në VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar;

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh”, ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjit 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; ligjit nr. 69/2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar; VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, Bashkia Shkodër paraqet për shqyrtim relacion për:

1. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Njësinë e Prokurimit, nga 4 që është aktualisht në 6 punonjës.
2. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit, nga 10 që është aktualisht në 11 punonjës.
3. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit, nga 60 që është aktualisht në 61 punonjës.
4. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë së Arsimit, nga 227, që është aktualisht, në 232 punonjës.
5. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, nga 27 që është aktualisht në 29 punonjës.
6. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër nga 238 që është aktualisht në 243 punonjës.
7. Shtesë numri të punonjësve të shërbimit me kontratë tek Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër me 10 punonjës.

Pra në total një rritje prej 26 punonjësish.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Njësia e Prokurimit vjen për arsye se Njësia e Prokurimit pjesë e Bashkisë Shkodër në strukturën e saj ka 4 punonjës nga të cilët 3 janë specialist dhe 1 përgjegjës.

Duke vlerësuar rritjen e vazhdueshme të ngarkesës së punës dhe përgjegjësisë të njësisë së prokurimit, vlerësojmë se burimet njerëzore aktuale nuk mjaftojnë për të garantuar realizimin me cilësi, në kohë dhe në përputhje me kërkesat ligjore të deytrave të ngarkuara.

Procedurat kërkojnë angazhim të detajuar, korrektësi në dokumentacionin e hartuar, ndjekje administrative dhe teknike, si dhe komunikim të vazhdueshëm me njësitë brenda dhe jashtë institucionit.

Në këto kushte, kërkohet shtimi i stafit për të garantuar respektimin e ligjit, përmirësimin e performancës dhe shmangien e vonesave apo gabimeve që mund të kenë pasoja financiare apo ligjore për institucionin.

Në këto kushte, arsyetojmë një shtesë numri të stafit të prokurimeve prej 2 nëpunës (Specialistë).

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit

Fluks i lartë i qytetarëve të cilët paraqiten dhe kërkojnë shërbim në sportelet e ZiIN të Bashkisë Shkodër këtu në qendër dhe në Njësinë Administrative Rrethinat bën të dosmosdoshëm nevojën për shtesë stafi me 1 (një) nëpunës specialist.

Për mbulimin e shërbimit të ZiIN për Nj.A Rrethinat për çdo muaj kemi dërguar specialist të ZiIN nga Bashkia qendër por kemi evidentuar se me këtë mënyrë nuk mund të realizohet 100% rrjedha e punës. Prandaj kërkojmë që për Nj.A Rrethinat të kemi një specialist të dedikuar për sportelin e ZiIN.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtorinë e Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit, konkretisht tek Kinema “Republika” vjen për arsye se Kinema “Republika” është një institucion shumë i rëndësishëm për jetën artistike të qytetit. Me miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me distributor vendas dhe të huaj, për të drejtën e shfaqjes së filmave dhe materialeve të tjera audio-vizuale, na lind nevoja e shtimit të personelit, me punonjës administrative, Ndihmës specialist në Kinema Republika, i cili do të merret me shitjen dhe arkëtimin e biletave për eventet dhe shfaqjet e filmave që do të jepen dhe zhvillohen në kinema.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Arsimit vjen për arsye se Drejtoria e Arsimit pjesë e Bashkisë Shkodër në strukturën e saj ka 58 njësi që ofrojnë

shërbime për 1972 fëmijë të grup moshës 0-6 vjeç, të ndara në: 44 kopshte pa drekë dhe 7 kopshte e 7 çerdhe me drekë.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Ligji Nr. 68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverijes Vendore” Ligji Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, VKB Nr. 756 datë 31.12.2024, “Për miratimin e strukturës të nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar, në përmbushje të detyrimeve ligjore, paraqesim kërkesën tonë për miratimin për shtesë të personelit të Drejtorisë së Arsimit, si më poshtë vijon:

- Bazuar në situatën aktuale duke iu referuar vitit shkollor 2024-2025 të kopshteve dhe të çerdheve ku kemi një numër të shtuar të rregjistrimeve të fëmijëve te arsimi parashkollor për shërbim me drekë dhe ambienteve të cilat mund të ofrojnë kapacitete më të mëdha akomoduese për frekuentimin e fëmijëve por rezulton se numri i punonjësve që mbulon aktualisht shërbimet në këto ambiente është më i vogël për të mbuluar kërkesat e qytetarëve për rregjistrim, nga këtu lind nevoja që për të plotësuar kërkesën e lartë për frekuentim të ambienteve ekzistuese dhe vendosjen në funksion të plotë të kapaciteteve të ambienteve që disponon Bashkia, të shtohet stafi i punonjësve arsimorë me staf administrative dhe mbështetës në kopshte dhe në çerdhe të Drejtorisë së Arsimit.
- Kjo shtesë në strukturën e kopshteve dhe çerdheve vjen gjithashtu pasi janë marrë për bazë kërkesat e komunitetit , kërkesa të sjella nga administratorët e njësive administrative dhe kryepleqve të lagjeve për shërbime edukative ndaj fëmijëve 0-3 dhe 3-6 vjeç.
- Gjithashtu është e nevojshme, nga vlerësimi i berë që për përmirësimin e përformacës dhe rritjen së standarteve të ofrimit të shërbimit dhe përmbushjes së funksioneve të ngarkuara me ligj për Drejtorinë e Arsimit, të shtohet specialist teknolog dhe shofer, konkretisht për sigurimin e cilësise ushqimore dhe garantimin, monitorimin e ofrimit të shërbimit në çdo kopsht dhe çerdhe me drekë por edhe në Konvikt si dhe në Shkollën Spaciale 3 Dhjetori. Per mbulimin e monitorimit të shërbimeve dhe nevojave në të 51 kopshtet e Bashkisë Shkodër dhe Njësive Administrative është e nevojshme shtimi i strukturës me staf administrative dhe mbështetës.

Në këtë kuptim për t’iu përgjigjur nevojave te qytetarëve për akses në shërbimet që ofron Bashkia si dhe për të garantuar standardin në cilësinë e ofrimit të shërbimeve si dhe për të respektuar përcaktimet ligjore në këtë fushë, e konsiderojmë të domosdoshme shtimin e strukturës së Drejtorise se Arsimit me 2 punonjës arsimorë (edukatore), 1 punonjës

administratë të dedikuar për çerdhet, 1 specialist (teknolog) si dhe 1 shofer në total prej 5 punonjës.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore kërkohet nga fakti se me afrimin dhe fillimin e sezonit turistik, dinamika e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore rritet ndjeshëm.

Me personelin që aktualisht disponojmë e kemi të pamundur mbulimin e plotë të zonave turistike (Shkodër, Velipojë dhe Theth) për evidentimin e plotë dhe të rregullt të të gjitha subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këto zona, nisur edhe nga afati i shkurtër kohor i sezonit turistik. Për këtë arsye kërkojmë rritjen e numrit të stafit të kësaj drejtorie me 2 nëpunës (inspektor).

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër.

Në kuadër të intensifikimit të veprimtarisë institucionale dhe zgjerimit të gamës së shërbimeve që ofron Bashkia Shkodër, është bërë e nevojshme rishikimi dhe përforcimi i kapaciteteve njerëzore për periudhën e verës dhe më gjerë. Aktualisht, struktura ekzistuese e punonjësve nuk mund të përmbushë në mënyrë optimale nevojat e reja që kanë lindur nga shtimi i funksioneve dhe aktiviteteve të bashkisë, si më poshtë:

- **Vendosja në funksion e Kinemasë së Shkodrës**, si një qendër multifunkionale kulturore, kërkon praninë e stafit teknik dhe logjistik për operimin e sallave, mirëmbajtjen, sigurinë, si dhe organizimin e aktiviteteve artistike.
- **Menaxhimi i plazheve publike pa pagesë në Velipojë**, përfshirë mirëmbajtjen, mbikëqyrjen, ofrimin e shërbimeve minimale për sigurinë dhe pastërtinë gjatë sezonit turistik, është një detyrë e re që kërkon angazhimin e personelit të përkohshëm në terren.
- **Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike në territorin e bashkisë**, si festivale, evente promovuese, ekspozita, aktivitete rinore e sportive, kërkon staf mbështetës për logjistikën, komunikimin dhe sigurinë e pjesëmarrësve.

Për të siguruar një menaxhim efektiv të këtyre proceseve dhe për të shmangur mbingarkesën mbi strukturat aktuale, **proponohet shtimi i numrit me 5 punonjës mirëmbajtje dhe shërbimi**, të cilët do të angazhohen me detyra të qarta sipas urdhrave të punës dhe nevojave operacionale të bashkisë.

Kërkesa për shtesë të numrit të punonjësve të punonjësve me kontratë në strukturën e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër vjen me qëllim përmirësimin e shërbimit të ujitjes në zonat ku ofrohet ky shërbim, dhe zgjerimin e hartës së mbulimit me këtë shërbim. Kostoja e tarifës së këtij shërbimi është përlllogaritur

referuar në shpenzimet e kryera për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitje, duke përfshijë çdo shpenzim të bërë për furnizimin me ujë.

Për vjeljen e tarifës së ujitjes do jenë të punësuar 10 punonjës sezonal për një periudhë 5 mujore, të cilët do kenë si detyrë gjithashtu menaxhimin e ujit për ujitje sipas kërkesave të fermerëve.

Sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë projekt vendimin paraqitur;

Për një ndryshim në VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar”;

Duke ju falenderuar!

KRYETAR

Benet BECI

